

FEDERATA E SHENJETARISE E KOSOVES

RREFYES PER REFER

NENTITUJT:

- Pjesa 1 Në përgjithësi për refer
- Pjesa 2 Marrja e licencës
- Pjesa 3 Vlefshmeria dhe vazhdimi i licencës
- Pjesa 4 Çvleftsimi i licencës
- Pjesa 5 Trajnimi i referëve
- Pjesa 6 Marrja e licencës më të lartë
- Pjesa 7 Kushtet e veçanta për marrjen e licencës
- Pjesa 8 Delegimi i referve
- Pjesa 9 Dispozitat përfundimtare
- Pjesa 10 Formularët për paraqitjen e licencës

VEREJTJE: Fjala “Refer” në kuptim të kësaj Rregullorje, ka të bëjë me refer të FSHK-së, dhe të FNSSH-së, që janë bartës të licencës. Fjala “Zhiri” kuptohet për ata refer të licencuar, të cilëve u janë ndarë detyrat e Zhirit në kampionatin e caktuar.

Pjesa 1.0 Në përgjithësi – për refer

- 1.1 Për arritjen e qëllimeve të veta, FSHK-ja i licenconë referët për t'i mbikëqyrë garat e shenjëtarisë dhe për të siguruar trajtim të njajtë dhe të ndërshtëm për të gjithë garuesit Referet plotësisht duhet të jenë të njohur me verzionet më të reja të Rregullave të FNSSH dhe të FSHK-së, për të mundur të këshillojnë, mbikëqyrin dhe ndihmojnë, nëse ka nevojë.
- 1.2 Licencat e referve janë të ndara në dy kategori: në nivel të FNSSH (“A” dhe “B”) dhe në tri kategori në nivel të FSHK-së (“C”, “D” dhe “E”).
- 1.3 FNSSH i lëshonë licencat e referve “A” dhe “B” në pajtim me udhëzimin e FNSSH për refer (Aneksi “J”), kurse FSHK-ja i lëshonë licencat e referve (“C”, “D” dhe “E”), si dëshmi për kualifikimin në harmoni me këto Rregulla.
- 1.4 Poseduesëve të autorizuar të licencës “B” u është mundësuar që si anëtarë zyrtar të zhirit të veprojnë në të gjitha garat e shenjëtarisë për të cilat vlenë licenca, duke marrë parasyshë disiplinat e përfshira, përfshirë Lojrat Olimpikë dhe Kampionatet botërore. Referëve me këtë licencë, po ashtu u është mundësuar mbajtja e seminareve zyrtare të FNSSH për refer, si dhe mbajtjen e seminareve të FSHK-së dhe të provimit për marrjen e licencës “C”, “D” dhe “E”.
- 1.5. Poseduesëve të autorizuar të licencës “B” u është mundësuar që si anëtar zyrtar të Zhirit të veprojnë në të gjitha garat e shenjëtarisë për të cilat vlenë licenca duke patur parasyshë disiplinat e përfshira, përveç në Lojrat Olimpikë dhe Kampionatet botërore, si dhe në mbajtjen e seminareve zyrtare të FSHK-së dhe të provimeve për marrjen e licencës “E”. Nëse për disa disiplina të përfshira (psh.3 dhe 4) nuk ka refer me licencë “A” të vlefshme, ligjerata dhe provimet zyrtare të FSHK-së për licenca “C”, “D” dhe “E” mund ti mbajnë edhe referët posedues të licencës së vlefshme për disiplinat e përfshira, me përvojë të madhe në ato disiplina.
- 1.6 FSHK-ja i lëshonë licencat e referve për këto disiplina:
 - 1.6.1 Gjuajtja me pushkë (1),
 - 1.6.2 Gjuajtja me pistoletë (2),
 - 1.6.3 Gjuajtja e figurave fluturuese (3),
 - 1.6.4 Gjuajtja e figurave levizëse (4),
 - 1.6.5 Vlerësimi i rezultateve (5).
- 1.7 FSHK-ja mund ti jep licenca gjyqtarit për një ose më shumë disiplina, por pas

- kryerjes me sukses të seminarit zyrtar të FSHK-së dhe të provimit për çdo disiplinë. Zakonisht , Nr.5 (vlërsimi i figurave) është e kombinuar me disiplinat nr.1 (pushka), nr.2 (pistoleta), kurse nr.3 (figurat fluturuese) dhe nr.4 (figurat lëvizëse) jipen pas kryerjes së seminarit të veçant dhe të provimit të FSHK-së.
- 1.8 Shërbimi profesional i FSHK-së dhe Kryetari i Këshillit të referëve të shenjëtarisë ose zavendësi i autorizuar mbajnë regjistrin e të gjithë fituesve të licencave. Çdo vit publikohen emrat e fituesve të rinj të licencave në dokumentet e FSHK-së.
- 1.9 Bartësit e licencave të FNSSH-së mund të punojnë si anëtar të zherit në Lojra olimpike dhe në Kampionatet botërore vetëm kur janë të deleguar nga Komiteti egzekutiv i FNSSH. Për kupat botrore, anëtarët e zherit delegohen nga ana e Sekretarit gjeneral dhe të Kryetarit të Komitetit për refer. Për garat e kontinenteve dhe rajonale, duhet të delegohen nga Konfederata e kontinenteve ose konfederatat regjionale.
- 1.10 Bartësi i licencës “C” të FSHK-së mund të punojnë si anëtar të Zherit në Kampionatet shtetërore, vetëm atëherë nëse janë deleguar nga Këshilli drejtues i FSHK-së. Për kupat shtetërore ose të garave shtetërore, anëtarët e zherit delegohen nga Kryetari dhe të Këshillit të referve të shenjëtarisë, ose të autorizuarit për refer. Për garat e komunave, anëtarët e Zherit mund të delegohen nga organi gjegjës të Komunës.

Pjesa 2.0 Marrja e licencës

- 2.1 Kandidati për refer praktikant duhet të ketë përvojë të nevojshme në sportin e shenjëtarisë si garues ose si punëtor i shenjëtarisë në organizimin e punëve në lidhje me garat e shenjëtarisë. Përvoja e nevojshme evidentohet në kuadër të organeve komunale të Klubeve të shenjëtarisë, të cilët janë kompetent për lëshuarjen e vërtetimit për statusin e **referit praktikant**, të cilën mund ta vërtetoi referi aktiv i asaj komune me spaku licencë “C” të FSHK-së. Kandidati për refer nuk lejohet të jenë më i ri se 16 vjeç. Statusi i referit praktikant u njihet garuesëve të regjistruar, të cilët në dy vitet e fundit kanë marrë pjesë në garat që mund të pranohen arritjet e rekordeve shtetërore.
- 2.2 Kandidati për marrjen e licencës “E” të referit, duhet ta ketë statusim e referit praktikant së paku dy vite, për çka Vërtetimin e jep organi kompetent i referëve të Komunës ose Këshilli i referëve në nivel të Federatës, të cilën e nënshkruan referi aktiv i vendit me licencë “C”. Përgjashtimisht nga paragrafi paraprak, vërtetimin mund ta japë edhe Shërbimi profesional i FSHK-së.
- 2.2 FSHK-ja licencat e referëve u jep edhe shenjëtarëve aktiv, të cilët edhe tani marrin pjesë në gara, në të cilat është e mundur arritja e rekordeve shtetërore, me atë që

nuk mund të veprojnë aktivisht si refer në asnjë garë në të cilën mbahet (grupa) disiplina në të cilën ata marrin pjesë.

2.3 Për marrjen e licencës së referit të FSHK-së është e nevojshme mësimi pregaditor dhe ushtrime – seminari dhe dhënja e provimit.

2.4 Provimet për marrjen e licencës “E” janë vetëm në formë shkrimi – testi.
Kandidatët për licencën “E” duhet:

- të paraqesin kërkesën për marrjen e licencës. Kërkesa mund të jenë e përbashkët për më shumë kandidat, me atë që për çdo kandidat të shenohen të dhënat e plota, si dhe të dhënat nga të cilat kjar shifet se i plotësonë kushtet për marrjen e licencës.

Çdo fletëparaqitje duhet të bëmbajë dy (2) fotografi të ferkshme të kandidatit (3x2 cm).

- të jenë refer praktikant së paku dy vite.
- që kanë marrë pjesë aktive së paku në dy gara në periudhë prej dy vitësh.
- Të kenë marrë pjesë në seminarin zyrtar për refer të FSHK-së.
- Të kenë dhënë pjesën me shkrim të provimit, përkatësisht të kenë kaluar pragun e poenave.

2.5 Kandidatët për licencën “D” dhe “C” duhet:

- të paraqesin kërkesën për marrjen e licencës. Kërkesa mund të jenë e përbashkët për më shumë kandidat, me atë që për çdo kandidat të shenohen të dhënat e plota të tij, si dhe të dhënat nga të cilat është e kjar se i plotësojnë kushtet për marrjen e licencës.

Çdo fletëparaqitje duhet të përmbajë dy (2) fotografi të ferkshme të kandidatit (3x2 cm).

- të jenë refer praktikant së paku dy vite.
- Të jenë pjesëmarrës aktiv në sèpaku dy gara në periudhë prej dy vitësh.
- të kenë marrë pjesë në seminarin zyrtar për refer të FSHK-së.
- Të kenë dhënë pjesën me shkrim të provimit, përkatësisht të kenë kaluar pragun e poenave.

2.6 Kandidatët për licencat “D” dhe “C” duhet:

- të paraqesin kërkesën për marrjen e licencës. Kërkesa mund të jenë e përbashkët për më shumë kandidatë, me atë që për çdo kandidat të shenohen të dhënat e plota, si dhe të dhënat nga të cilat kjo shifet se i plotësojnë kushtet për marrjen e licencës.

Çdo fletëparaqitje duhet të përmbajë dy (2) fotografi të ferkshme të kandidatit (3x2 cm).

- të jenë bartës të licencës “E”, përkatësisht “D” së paku dy vite,
 - të kenë marrë pjesë si refer aktiv në së paku dy gara në periudhë prej dy vitësh,
 - të kenë marrë pjesë në seminarin zyrtar për refer të FSHK-së,
 - të japin pjesën me shkrim të provimit, përkatësisht të kalojnë pragun e poenave sipas licencave. Me atë fitojnë të drejtën për pjesën përfundimtare të provimit, i cili në rregullore është pjesa praktike e provimit, e nëse nuk është e mundur me i realizuar kushtet për pjesën praktike të provimit, ose mund të kalohet si pjesë gojore e provimit, me atë, që me pyetje duhet të simulohen rastet nga praktika.
- 2.7 Intervistuesit e FSHK-së (ose Këshilli i referve të shenjëtarisë) do të shiqojnë dhe lejojnë fletëparaqitjet complete të kandidatëve, dhe të lejojnë kërkesën për dhënjën e licencës.
- 2.8 Pas lejimit udhëheqësia e FSHK-së do të lëshojë licencën. Për të qenë e vlefshme duhet të jenë e nënshkruar nga ana e Kryetarit të FSHK-së dhe Kryetarit të Këshillit të referve të shenjëtarisë të FSHK-së.
- 2.9 Taksa në kundërvlerë prej 20.-E, duhet të paguhet me rastin e paraqitjes së çdo fletëparaqitje për marrjen e licencës.

Pjesa 3.0 Vlefshmeria dhe vazhdimi i licencës

- 3.1 Të gjitha licencat e referve të FSHK-së jipen për katër vite.
- 3.2 Pas kalimit të atij afati, licenca mund të përseritet.

- 3.3 Kandidati duhet të paraqës kërkesën e vetë për përsëritjen e licencës në selinë e FSHK-së bashk me formularin e plotësuar për përsëritjen e licencës (shiko formularin në fund të Rregullorës).
- 3.4 Fletëparaqitja duhet të përmbajë dy (2) fotografi të ferkshme të kandidatit (3x2 cm).
- 3.5 Nevojitet argumenti i aktiviteteve të kandidatit si anëtar i Zhirit ose i referitë në sēpaku katër gara në periudhē prej katër vitësh dhe kandidati duhet të jenë i njoftuar me publikimet e rregullave të rëndēsishme të FNSSH dhe të FSHK-së, për çka deshmonē vërtetimi mbi pjesēmarrjen në seminar.
- 3.6 Licenca e vlefshme nuk do të duhej të kēthehet kur paraqitet për përsëritje, edhe pse pushonē të vlejē pas datēs sē skadimit. Fletëparaqitjet për përsëritjen e licencēs duhet të dorēzohen sē paku tre muaj para skadimit të vlefshmerisē sē licencēs.
- 3.7 Kryetari i Kēshillit të referve të shenjētarisē, ose zavendēsi i autorizuar në bashkpunim me zyrën e FSHK-sē ēshtē i ngarkuar për përritjen e licencave. Licenca e pērrirē do ti kēthehet kandidatit.
- 3.8 Taksa në kundërvlerē prej 10.-EUR, duhet të paguhet çdo herē me rastin e përritjes sē licencēs.

Pjesa 4.0 Skadimi i licencēs

- 4.1 Kur licenca e referit të shenjētarisē të FSHK-sē skadon pas katër vite, bartēsi i licencēs do të shlyhet nga regjistri i referve të FSHK-sē, nēse atē nuk e pērrirē në dy vitet e ardhshme. Nē rastet e tilla çdo licencē e ardhshme do të mirret në pajtim me Pjesēn 2 (marrja e licencēs), duke përfshirē prezencēn në seminare.
- 4.2 Federata nacionale bartēsit të licencēs, në çdo kohē, ka të drejtē në qvleftēsimin e licencēs sē referit të FSHK-sē ose të FNSSH-sē. Bartēsi i licencēs mund të jenē i hequr nga regjistri dhe me atē rast ēshtē i obliguar që licencēn tia kēthej FSHK-sē.
- 4.3 Licenca e referit mund të çvleftēsohet nēse referi nuk i plotēsionē dētyrat e veta si refer ose dēmtton interesat apo autoritetin e FSHK-sē. Bartēsi dotē hiqet nga regjistri i FSHK-sē ose FNSSH-sē dhe licenca duhet ti kēthehet FSHK-sē. Tē gjitha licencat e FSHK-sē. Tē gjitha licencat e referve mbesin pronē e FSHK-sē.
- 4.4 Propozimin për fshirjen nga regjistri i referve ka të drejtē çdo refer, klubet dhe organizatat tjera të shenjētarisē, në të cilat ēshtē edhe bara e paraqitjes sē

argumenteve (arësyeve). Vendimin për propozimin e aprovon Komisioni disiplinor i FSHK-së, në pajtim me aktet normative të FSHK-së.

Pjesa 5.0 Seminaret e referëve

- 5.1 Vetëm seminarët dhe provimet të cilat i mbajnë ligjeruesit e pranuar nga FSHK-ja do të konsiderohen si seminare zyrtare për refer. Shpallja duhet të përmbajë:
- 5.2 Ku do të mbahet seminari,
- 5.3 Data e mbajtjes së seminarit,
- 5.4 Emrat e disiplinave të shenjëtarisë, të cilat i mbulonë seminari,
- 5.5 Emrat e bartësve të licencuar “A” të FNSSH-së të propozuar (me kusht “B” në pajtim me nenin 1.4, dhe 1.5 të këtij seminari) për realizimin e këtij seminari (duhet të përmbajnë licencën e vlefshme “A” (“B”) për disiplinat që janë në pyetje),
- 5.6 Cilat shpenzime do të mbulohen nga ana e kandidatëve.
- 5.7 Regjistri i kandidatëve që do të marrin pjesë në seminar, përkatësisht në provim.
- 5.8 Baza për seminarët e referëve të FSHK-së është udhëzuesi FSHK-së për seminar. Qëllimi është që për kandidatë e FSHK-së tu sigurohet licenca, njohjen e Rregullave dhe zbatimin e tyre duke marr parasyshë disiplinat për të cilat të jenë të licencuar. Veçmas, kandidatët për licencë “D” dhe “C” duhet të kenë përvojë praktike të fituar në detyrat zyrtare në gara. Nënkuptohe që kandidatët për seminarët dhe provimet e referëve duhet të kenë licencën e nevojshme paraprake të referit.
- 5.9 Çdo pjesë e seminarit duhet të fillojë me shpjegimin e kuptimit dhe përmbajtjes të seminarit dhe provimit, pas së cilës pasonë përshkrimi i detyrave të referit.
- 5.10 Disiplinat e pushkës gjithëashtu përfshijnë edhe gjuajtjen me pistoletë në 50 dhe 10 m.
- 5.11 Nëse mbahet seminar i veçant të disiplinës së pistoletës në 25 m, duhet të përfshihet gjuajtja me pistoletë në 10 dhe 50 m.
- 5.12 Figurat fluturuese, figurat lëvizëse, përbërja elektronike e figurave organizohet ndamas.

- 5.13 Organizatori është përgjegjës për sigurimin e lokalit për seminar me paisjet dhe mjetet e nevojshme për realizimin dhe përcjelljen cilësore të seminarit.
- 5.14 Rekomandohet që mos të jenë më shumë se 30 vijues në seminar, disiplinë dhe për një intruktor. Për të qenë seminari kualitativ rekomandohet që seminari të kenë në minimum 12 vijues.
- 5.15 Dëshirohet që kandidatët, të cilët marrin pjesë në seminar, të kenë përvojë kualitative si refer.
- 5.16 Çdo kandidat duhet të plotësojë formularin për regjistrim me të dhëna për emrin, adresën dhe datëlindjen. Kandidati duhet të shenojë përvojën e vetë të kaluar mësimore dhe diturinë e veçant të cilën e ka fituar nëpërmjet detyrave në gara.

Pjesa 6.0 Marrja e licencës më të lartë

- 6.1 Baza për marrjen e licencës “D” dhe “C” është cekë në Pjesën 3.0 të këtyre Rregullave.
- 6.2 Baza për propozimin e kandidatit për marrjen e licencë së referit “B” të FNSSH është:
- posedimi i licencës më të lartë nacionale “C” në periudhë sëpaku prej katër vite,
 - përvojë referimi në sëpaku dy gara ndërkombëtare, në të cilat kanë marrë pjesë sëpaku pesë shtete dhe sëpaku në tri gara, në të cilat është e mundur arritja e rekordeve shtetërore, në pesë vitet e fundit, ose
 - përvojë referimi sëpaku në pesë gara në të cilat është e mundur arritja e rekordeve shtetërore, prej të cilave sëpaku në dy në cilësinë e anëtarit të Zhirit, në pesë vitet e fundit.
 - Njohja e njerës nga gjuhët zyrtare të FNSSH (Statuti i FNSSH).
- 6.3 Bazat për marrjen e licencës së referit “B” janë caktuar në Udhëzuesin për refer të FNSSH-së
- 6.4 Baza për marrjen e licencës së referit më të lartë nga “B” në licencën e referit “A” është përvojë e fituar, si refer vite me radhë.
- 6.5 Është e nevojshme koha e kaluar prej sëpaku katër vite si refer i licencuar “B”, dhe
- 6.5.1 Kandidati duhet të ketë përvojë referi në sëpaku 5 gara ndërkombëtare, në të cilat

kanë marrë pjesë sëpaku 5 shtete. Në sëpaku dy gara kandidati duhet të jenë anëtar i Zherit, kurse me kërkesë të veçant në tri gara tjera duhet të jenë referi kryesor i vijës së zjart, refer kryesor, Kryetar klasifikues ose kryetar i Kontrollit teknik. Marrja e licencës më të lartë e cila bazohet vetëm në nevojën e periudhës kohore, por edhe në qenjën e pamjaftueshme të përvojës në gara nuk do të pranohet.

- 6.6 Federata nacionale duhet të dorëzojë fletëparaqitjen në formularin zyrtar (shiko formularët në fund të Udhëzuesit të FNSSH-së) me dy (2) fotografi të ferkshme të kandidatit 3x2 cm.
- 6.7 Komiteti i FNSSH-së për refer do të vendosë për marrjen e licencës më të lartë në mbledhjen e vetë vjetore. Në pajtim me këtë, fletëparaqitjet për marrjen e licencës më të lartë duhet të dorëzohen në selinë e FNSSH-së mëse voni deri më 31 dhjetor.
- 6.8 Kur të lejohet marrja e licencës më të lartë, selia e FNSSH-së do të leshojë licencën e re të FNSSH-së e cila do ti dërgohet Federatës nacionale në mënyrë të njëjtë si edhe licencat tjera të lëshuara.
- 6.9 Taksa për marrjen e licencës më të lartë është 20 Franga zvicerane.
- 6.10 Shtimi i disiplinave tjera në licencat egzistuese (“A” ose “B”),** Disiplinat shtesë do të shtohen në licencën egzistuese vetëm në rastin, kur kandidati i ka kaluar seminarët gjegjëse për ato disiplina. Procedura është e njëjtë si edhe te marrja e licencës së re ose vazhdimi i licencës egzistuese.

Pjesa 7.0 Kushtet e veçanta për marrjen e licencës së referit

- 7.1 Në rastet e veçanta, kur është evidente mongesa e personelit kualitativ në disiplina, ku është e mundur arritja e rekordeve shtetërore, është e mundshme ndarja ose plotësimi i licencës së referit.
- 7.2 Kandidatët duhet ti plotësojnë formularët në pajtim me nenin 2.6.
- 7.3 Kërkesën e merr dhe për te vendosë Kryetari i FSHK-së me Këshillin e referve të shenjëtarisë. Procedura është e njëjtë me atë të përshkruar në nenet 2.8. dhe 2.9.
- 7.4 Licenca e marrur në atë mënyrë do të përfshihet në regjistrin vjetor të fituesëve të licencave.

- 7.5 Licenca e marrur në atë mënyrë mund ti ipet vetëm individëve shumë kualitativ. Medoemos duhet të zbatohen standardët e zakonshme, por ndërrohet procedura administrative.

Pjesa 8.0 Delegimi i referëve

- 8.1 Delegimi i referëve në gara të ndryshme nga programi vjetor i garave të FSHK-së ose të garave tjera të shenjëtarisë, bëhet mvarësisht nga niveli i garave dhe licencave të referëve.
- 8.1.1 Delegimin e referëve për garat e klubeve, ose të nivelit komunal, mund të bëjë trupi – organi komunal i referëve nga regjistri i tyre i referëve. Për garat e organizuara në nivel më të lartë se i garave komunale, referët i cakton Këshilli i referëve i FSHK-së.
- 8.1.2 FSHK-ja, përkatësisht Këshilli i referëve të shenjëtarisë të FSHK-së ose udhëheqësi i referëve, është i obliguar të emrojë Këshillin organizativ, për çdo garë në nivel shtetëror, delegatin teknik dhe kryetarin e Komisionit klasifikues, dhe të vërtetojë regjistrin e referëve në atë garë, si për kah numri i referëve dhe funksioneve, ashtu edhe për kah përbërja e referëve. I njëjti është i nevojshëm si për kah harmonia e kualitetit dhe numrit të nevojshëm të referëve për gara të ndryshme, me mundësitë që duhet mundësuar pjesëmarrjen e numrit më të madh të referëve.
- 8.2 Komiteti për referë të FNSSH-së do të emrojë Komitetin egzekutiv numër të mjaftuar të Zhirit dhe zvendës për Gara botrore dhe Lojra olimpike. Komiteti për referë të FNSSH-së gjithashtu do të emrojë anëtarët e Zhirit për Kupa botrore në pajtim me udhëzimin për Kupa botërore.
- 8.2.1 Konfederatat kontinentale dhe regjioale të pranuar nga FNSSH-së duhet të emrojnë dhe caktojnë anëtarët e Zhirit për kampionatet dhe garat e tyre.
- 8.2.2 Komiteti organizativ, ose Federata organizatore është përgjegjëse për caktimin e anëtarëve të Zhirit për gara tjera ndërkombëtare dhe kampionate nacionale, të cilat mbahen në pajtim me Rregullat e FNSSH-së.
- 8.3 Të gjithë anëtarët e Zhirit për kampionatet nacionale dhe të nivelit ndërkombëtar duhet të posedojnë licencat e FNSSH-së të zbatueshme (të disiplinave) për të gjitha garat ku mund të realizohen rekordet shtetërore ose botrore. Në të gjitha garat tjera, të cilat mbahen sipas Rregullave të FNSSH-së, anëtarët e Zhirit duhet të kenë licencat e vlefshme të FNSSH-së.
- 8.3.1 Në garat ku pranohen rekordet shtetërore dhe botërore, udhëheqësit e ekipeve, personat zyrtar dhe shenjëtarët nuk lejohet të jenë anëtar të Zhirit. Në të gjitha

garat tjera, personat e ekipeve, nuk do të duhej të jenë anëtar të Zhirit ose refer.

- 8.3.2 Eshtë e dëshirueshme që personat udhëheqës , të cilët marrin pjesë në garat shtetërore ose ndërkombëtare të posedojnë licencën gjegjëse të FNSSH-së. Dëtyrat dhe obligimet të cilat veçmas i kërkojnë licencat e FNSSH-së, janë referi kryesor i vijës së zjart, referi kryesor, kryetari i komisionit klasifikues dhe i kontrollës teknike.
- 8.3.3 Referi i vijës së zjart, referët në klasifikim, referët në kontrollën teknike, gjithashtu duhet të kalojnë arsimimin zyrtar për licencë të FNSSH-së, përkatësisht të kenë licencën gjegjëse të FSHK-së.
- 8.3.4 Personat të cilët janë në detyra të përmendura në 8.3.2 dhe 8.3.3 nuk lejohet të jenë anëtar të asnjë Zhiri në ato gara.

Pjesa 9.0 Dispozitat përfundimtare

- 9.1 Nëse egziton dyshimi mbi domethanjen ose kuptimin e këtyre Rregullave ose nëse egzistonë kundërthënja në mes të këtyre Rregullave dhe rregullave të FNSSH-së, i vlefshëm është teksti i Rregullave të FNSSH-së.
- 9.2 Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Rregullave bëhet në mënyrë dhe sipas procedurës të paraparë për aprovimin e tyre.
- 9.3 Spjegimin e këtyre Rregullave e jep Këshilli drejtues i FSHK-së.
- 9.4 Rregullat hynë në fuqi ditën e aprovimit, kurse zbatohen prej 02.12.2007.

Pjesa 10.0 Formularët për licenca

- 10.1 Me qëllim të thjeshtimit të administrimit me rastin e marrjes së licencës, formularët në vijim do të përdorën me rastin e plotësimit të kërkesës për licencë “B”, marrjen e licencës në të lartë ose përtrirjen e sajë.

FEDERATA E SHENJETARISE E KOSOVES

RREGULLORJA

**PER REFERE TE SHENJETSRISE
(PERVEÇ PER FIGURA FLUTURUESE)**

Prishtinë, 2007